



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magistrates { ... }, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Ilir Toska*. Nuk mori pjesë në këtë çështje të rendit të ditës anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Fatmira Luli*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
- 7. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të mediave.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e Këshillit të programuar më datë 17.06.2021, ora 11:00.

Janë të pranishëm të gjithë anëtarët, përveç zonjës Fatmira Luli e cila është në një angazhim ku përfaqëson Këshillin, dhe zoti Ilir Toska, i cili për shkaqe të arsyeshme, e ka të pamundur të jetë sot në mbledhje.

Lidhur me rendin e ditës, sot nga ana e Këshillit do të shqyrtohen 9 çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}”.

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}”.

Çështja e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e tre anëtarëve në bordin drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”. (shtyrë nga mbledhja e datës 18.03.2021)

Çështja e gjashtë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.

Çështja e shtatë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Çështja e tetë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Çështja e nëntë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Jeni dakord me rendin e ditës?

Nëse nuk ka kundërshtime, atëherë, fillojmë me çështjen e parë që ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

*(Hyn në sallën e mbledhjes z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.)*

**Naureda Llagami:** Përshëndetje!

Hapim seancën dëgjimore në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkak të fillimit të procedimit disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Verifikojmë prezencën e palëve.

Nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është i pranishëm vetë zoti Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

**Artur Metani:** Po! Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

**Naureda Llagami:** Ndërkohë që nga ana e magjistrates, magjistratja nuk është e pranishme, as përfaqësuesi i saj.

Shkurtimisht, për t'ju rikujtuar situatën lidhur me çështjen konkrete:

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 22.04.2021, është regjistruar me aktin nr.{...} prot., kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Më datë 26.04.2021, Këshilli me vendimin nr.175 caktoi anëtarin e Komisionit Disiplinor, Z. Medi Bici, si relator për procedimin disiplinor në ngarkim të magjistrates {...}.

Ky vendim i është njoftuar gjyqtares nëpërmjet shkresës nr. {...} prot., datë 27.04.2021, ashtu si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën me të cilën ajo ka komunikuar me KLGJ, dhe konkretisht me e-mailin {...}.com më datë 27.04.2021.

Pas caktimit të relatorit, Këshilli në mbledhjen e datës 07.05.2021, me vendimin nr. 189, bazuar në nenin 138, pika 2 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, caktoi datën 17 qershor 2021, ora 11:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}.

Vendimi për caktimin e seancës dëgjimore i është njoftuar gjyqtares me shkresën nr. {...} prot., datë 10.05.2021. Gjithashtu në këtë shkresë ajo është bërë me dije edhe lidhur me të drejtat e saj që gëzon në një procedim disiplinor parashikuar në nenin 141,

pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht:

- a) për të paraqitur një parashtrësë me shkrim në afatin e caktuar;
- b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
- c) për të thirrur dëshmitarë;
- ç) për të paraqitur dokumente;
- d) për të marrë masa të tjera...;
- dh) për t’u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative; ...

Gjithashtu në njoftim i është caktuar si afat gjyqtarës që brenda datës 7 qershor të paraqesë një parashtrësë me shkrim.

Ndërkohë që ky njoftim, për caktimin e seancës dëgjimore, përveç rrugës zyrtare, është dërguar në drejtim të gjyqtarës edhe nëpërmjet postës elektronike, në adresën e-mailin më datë 10.05.2021.

Nga ana e gjyqtarës nëpërmjet postës elektronike më datë 2 qershor ka paraqitur parashtrësat si dhe dokumentet shoqëruese. Në përmbajtje të parashtrësave magjistratja {...}, ndërkohë që parashtron dëshirën për t’u paraqitur para Këshillit të Lartë Gjyqësor, thekson se pavarësisht vullnetit të saj, e ka të pamundur paraqitjen për shkaqe objektive, duke qenë se në datën 14 maj ka kryer një ndërhyrje të rëndë kirurgjikale në kolonën vertebrale. Në këto kushte, duke vlerësuar rëndësinë që ka zhvillimi i kësaj seance dëgjimore ajo kërkon nga Këshilli i Lartë Gjyqësor shtyrjen pa afat të zhvillimit të seancës dëgjimore, kur magjistratja të mund të jetë fizikisht e aftë për të udhëtuar dhe marrë pjesë në këtë seancë.

Kjo është situata që Këshilli ndodhet sot.

Dëshiroj t’ia jap fjalën Inspektorit se ç’vlerësim keni mbi parashtrësën e bërë ana e magjistrates.

*Artur Metani:* Për kërkesën për shtyrje?

*Naureda Llagami:* Po!

**Artur Metani:** Dje në fakt ka dalë edhe në faqen zyrtare të KPK-së vendimi për magjistraten {...}. Nga ajo që lexova, çështja për të cilën ka filluar inspektimin dhe hetimin Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është lënë në kompetencë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nuk e di nëse Këshilli e ka marrë edhe zyrtarisht këtë vendim, pra ju ka ardhur apo jo?!

Çështjen e shtyrjes e lë në vlerësim të Këshillit, por do mendoja që nëse do shtyhet, të merret të paktën zyrtarisht edhe vendimi i marrë nga KPK-ja dhe të administrohet nga Këshilli.

**Naureda Llagami:** Nga kolegët ndonjë diskutim përpara se të vendosim?

**Brunilda Kadi:** Në lidhje me pjesën procedurale për ta shtyrë, unë vlerësoj që duhet t'i pranohet kërkesa magjistrates, për shkakun që ajo paraqet, i cili nga ana ime vlerësohet si shkak objektiv. Njëherësh, duke qenë se arsyeja e vendosjes së kësaj date për seancën dëgjimore, Këshilli e bazoi edhe në një arsye tjetër, që ishte marrja e vendimit nga KPK dhe siç rezulton si e dhënë publike, ky vendim është arsyetuar dhe është publikuar dje dhe duhet ta kërkojmë që të na paraqitet nga ky Komision zyrtarisht një kopje e vendimit.

Gjithashtu, në lidhje me aktet e dosjes, siç rezulton është njoftuar edhe avokate {...}, ndoshta me arsyetimin që ka një akt përfaqësimi për magjistraten. Nga njohja me atë akt, unë vlerësoj që ka probleme dhe me atë akt, nëse magjistratja do vlerësojë që do të përfaqësohet nga kjo avokate, mendoj që nuk i ka tagrat e këtij përfaqësimi.

Vlerësoj që në vendimin e Këshillit, nëse do shtyhet për t'i dhënë kohë magjistrates për arsyen që ka kërkuar, ajo të njoftohet edhe për faktin e rregullimit të aktit të përfaqësimit, pra nëse do vlerësojë të përfaqësohet nga një avokat apo nga cilido subjekt tjetër, të paraqesë aktin e përfaqësimit, duke pasur parasysh që ai që ndodhet në dosje është me të meta. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Kadi!

Ndonjë diskutim?

Po, zonja Ukperaj!

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit, zonja Kryetare!

Pa dashur që të përsëris ato që tha zonja Kadi, edhe unë bashkohem.

Sot seanca dëgjimore nuk mund të zhvillohet për një shkak objektiv, por gjithsesi, një nga parimet e procedimit disiplinor është e drejta për një proces të rregullt, çka nënkupton edhe përfundimin e procesit disiplinor brenda një afati të arsyeshëm. Prandaj, veç atyre që tha zonja Kadi, unë mendoj që duhet të njoftohet magjistratja që, shtyrja e seancës dëgjimore në një afat tjetër, që maksimumi sipas ligjit mund të jetë 1 muaj, është shtyrja e fundit dhe e vetme që mund të bëjë Këshilli, duke i shpjeguar detyrimin që ka për të marrë të gjitha masat që seanca e ardhshme të jetë efektive sepse gjendja e saj shëndetësore mund të zgjasë, në këto kushte që është, pafundësisht, dhe nëse ajo nuk do të rregullojë mënyrën e përfaqësimit të saj, gjithmonë do të jemi përpara këtij kushti objektiv. Prandaj unë vlerësoj, që përveç faktit që duhet të njoftohet për seancën e ardhshme, duhet të njoftohet edhe për mënyrën e rregullimit të përfaqësimit të saj. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

Ndonjë diskutim?

***Medi Bici:*** Zonja Kryetare, edhe unë në cilësinë e relatorit bashkohem me mendimin e kolegëve dhe kërkesës që bëri edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Kërkesa për shtyrje e magjstrates është legjitime pasi ajo më datë 14.05.2021 ka bërë një ndërhyrje kirurgjikale në kolonën vertebrale dhe ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore duke shprehur dëshirën që të paraqitet vetë personalisht në seancën dëgjimore.

Nga studimi që i kemi bërë materialeve, edhe ne e kemi konstatuar që Prokura e Posaçme e datës 04.11.2020 është dhënë posaçërisht për seancën gjyqësore që ka pasur ndërmjet paditëses {...} dhe i paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor për çështjen që ka pasur në Gjykatën e Apelit Administrativ, dhe kjo prokurë është me të meta. Ne kemi njoftuar edhe avokaten {...}. Nuk kemi marrë shprehje interesi prej saj. Gjithashtu, ashtu siç tha

edhe Inspektori, mbrëmë në darkë ka dalë në faqen zyrtare të KPK-së vendimi nr. {...}, datë 30.04.2021 për subjektin e rivlerësimit znj. {...} dhe në fund vendimi ka konkluduar që çështja i përket në kompetencë KLGJ-së. Ky vendim nuk na ka ardhur zyrtarisht, është në fazën e njoftimit dhe pastaj në fazën e hetimit, kështu që unë do t'i propozoja Këshillit shtyrjen në bazë të nenit 36 të Rregullores, për në datën 17 korrik, që në fakt i bie ditë e shtunë. Kështu që mbetet data 19 korrik ose datat 15-16 korrik.

**Naureda Llagami:** Atëherë, jemi dakord që ta shtyjme seancën dëgjimore më datë 19 korrik, ora 11:00? Nga ana e Inspektorit?

**Artur Metani:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Duhet parë nëse është festa e Kurban Bajramit.

**Medi Bici:** Është me datë 20, Bajrami.

**Naureda Llagami:** Atëherë, doni me datë 16, që është e premte?

Atëherë, jemi dakord që seancën dëgjimore ta shtyjme më datë 16 korrik, ora 11:00?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, me kaq po mbyllim seancën e sotshme.



*(Largohet nga salla e mbledhjes zoti Artur Metani.)*

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit { ...}”, relator z. Erjon Muharremaj.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Ilir Toska**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}”, relator z. Erjon Muharremaj.

*(Ftohet të futet në sallë magjistrati {...}).*

**Naureda Llagami:** Përshëndetje!

Atëherë, siç jeni vënë në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor sot do merren në shqyrtim dy projektraportet e vlerësimit për zotin {...}. Projektraporti i parë ka të bëjë me periudhën e gradimit, që i përkon viteve të vlerësimit 2013-2016. Projektraporti i dytë ka të bëjë me periudhën për vitin 2019.

Sipas procedurës që ka Këshilli, projektraporti është vënë në dispozicion nga ana e Komisionit magjistratit dhe në momentin që magjistrati ka parashtresa, kundërshtime apo sqarime, gjithashtu ka të drejtën për të qenë prezent dhe për t’u dëgjuar në shqyrtimin e këtij projektraporti.

Sipas procedurës, fillimisht fjala i jepet relatorit të projektraportit. Ai pasqyron konkretisht projektraportin tuaj dhe më pas ju jepet fjala juve, ku shkurtimisht do

fokusoheni në pretendimet që keni mbi gjetjet e projektraportit dhe në përfundim ju largoheni dhe Këshilli vendos lidhur me vlerësimin tuaj.

Pa humbur kohë po ia jap fjalën zotit Muharremaj, lidhur me prezantimin e projektraportit.

***Erjon Muharremaj:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Siç relatuat edhe juve, jeni njohur tashmë me projektraportin edhe me të gjitha aktet që i përkasin dosjes së vlerësimit.

Gjyqtari ka paraqitur kundërshtimet e veta lidhur me gjetjet e projektraportit dhe unë do të ndalem vetëm tek ato pika për të analizuar me hollësi treguesit për të cilët gjyqtari ka paraqitur parashtrimet. Periudha për të cilën vlerësohet gjyqtari, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në lidhje me “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, sa i përket “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, vlerësohet si “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 25 pikë.

“Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 25 pikë.

“Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, shkalla e aftësisë vlerësohet “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 10 pikë.

“Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 25 pikë.

Në tërësi, për kriterin e parë të “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, propozimi është që të pikëzohet me 100 pikë, në nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarit”, në lidhje me “Aftësinë e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë”, referuar të dhënave është vlerësuar në projektraport që shkalla e aftësisë i përket kategorisë “31-40%” dhe është propozuar që të vlerësohet me 6 pikë.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për 3 (tre) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes.

Konkretisht, në çështjen e datës 13.11.2015, regjistruar në gjykatë në datën 23.09.2015, gjykimi ka përfunduar për 51 ditë, duke përfunduar jashtë afatit ligjor prej 20 ditësh, të parashikuar në nenin 610 të K.Pr.Civile.

Në çështjen e datës 10.04.2014, regjistruar në gjykatë në datën 21.03.2014, gjykimi ka përfunduar për 20 ditë, duke përfunduar jashtë afatit ligjor prej 10 ditësh, të parashikuar në nenin 522 të K.Pr.Civile.

Në çështjen e datës 24.03.2015, regjistruar në gjykatë në datën 23.03.2015, gjykimi ka përfunduar për 1 ditë, duke përfunduar brenda afatit ligjor prej dyzet e tetë orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.

Nga këto, duke iu referuar çështjeve për të cilën ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, rezulton se për 2 (dy), nga 3 (tre) prej tyre, ose 66% të tyre, vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor.

Sa i përket propozimit në lidhje me këtë tregues, gjyqtari ka paraqitur kundërshtimet e tij, duke parashtruar se:

“Në lidhje me çështjen e parë, është gjykuar për 51 ditë por nuk është pasur parasysh në vlerësim fakti se data e regjistrimit të çështjes në gjykatë 22.09.2015, nuk mund të barazohet me datën kur dosja konkrete i ka kaluar nga sekretarja gjyqësore e gjyqtarit për veprim, pra data 28.09.2015, duke kaluar në rastin konkret me 6 ditë.”

Nga ana tjetër gjyqtari vlerëson se: Në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së gjykimit nuk mund të kufizohet vetëm në leximin mekanik të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, por respektimi i afateve duhet parë konkretisht në varësi të llojit të gjykimit dhe të sjelljes së palëve. Nëse mbahet parasysh ky lloj këndvështrimi, gjyqtari mendon se arrihet në përfundimin se kjo padi, konsideruar atëherë si të tillë, e ka gjykuar në kohë rekord duke pasur parasysh edhe mundësinë fizike për të gjykuar, sjelljen e palëve dhe nevojën për realizimin e njoftimeve efektive për palët në proces.

Së dyti, në lidhje me çështjen e përfunduar të datës 10.04.2014, që është gjykuar për 20 ditë, sipas gjyqtarit, nuk është mbajtur parasysh fakti se data e regjistrimit të

çështjes në gjykatë më 21.03.2014 (ditë e premte), nuk mund të barazohet me datën kur dosja konkrete i ka shkuar gjyqtarit për veprim. Nga momenti kohor i marrjes së dosjes, duke llogaritur edhe nevojën e njoftimit të kërkuarit me letërthirrje është caktuar seanca gjyqësore në datën më të parë të mundshme, që ka qenë data 08.04.2014. Në këtë rast, kërkesa është konstatuar me të meta, konform nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile, duke mbetur pa veprime. Në vijim, edhe seanca e lënë një ditë më pas në datën 09.04.2014 është shtyrë, duke zgjatur afatin për plotësimin e të metave dhe gjykimi ka përfunduar në datën 10.04.2014.

Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme, gjyqtari ka paraqitur nëpërmjet postës elektronike në datën 11.06.2021 edhe axhendën e gjykimeve për periudhën mars-prill 2014, duke e vlerësuar si provë që paraqet ngarkesën e madhe të punës që ka përballuar në atë kohë gjyqtari.

Duke iu referuar akteve të dorëzuara nga gjyqtari, nëse në llogaritjen e raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor, nuk do përfshiheshin çështjet e mësipërme në të cilën situata procedurale nuk ka qenë përgjegjësi e gjyqtarit, atëherë duke iu referuar çështjeve për të cilën ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, rezulton se vetëm për një prej tyre vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor. E shprehur në përqindje 33%.

Më duhet të theksoj që ndryshe nga afatet e arsyeshme ku sigurisht luan rol edhe sjellja e palëve dhe koha e nevojshme për realizimin e njoftimeve, afatet ligjore duhet të respektohen nga gjyqtari për shkak se vetë ligjvënësi për shkak të natyrës së çështjes ka parashikuar afate më të shkurtra se ato të arsyeshme. Pavarësisht se mosrespektimi i afateve ligjore nuk sjell pasoja juridike referuar Kodit të Procedurës Civile, ai mbahet parasysh në vlerësimin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”. Në rastin konkret, çështja civile me objekt: “Kundërshtim veprimesh përmbartimore” është gjykuar vetëm mbi bazën e praktikës përmbartimore që dëshmon shkallë të ulët kompleksiteti.

Bazuar në këto konsiderata, nuk mund të arrihet deri në pikëzimin maksimal në lidhje me këtë tregues, por në cilësinë e relatorit propozoj që gjyqtari të pikëzohet në një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë

afatit, konkretisht të konsiderohet se i përket kategorisë 21-30%, duke e pikëzuar me 9 pikë.

Pra propozoj që nga vlerësimi fillestar prej 6 pikësh, gjyqtari të vlerësohet një nivel më lart, duke u pikëzuar me 9 pikë.

Në lidhje me “Plotësimin e standardeve minimale kohore”, shkalla e aftësisë konsiderohet nga “0-10%”, pikëzimi maksimal 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, vlerësohet që gjyqtari ka shkallën maksimale të aftësisë, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Në lidhje me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”, është propozuar që i përket kategorisë 87-93% dhe është propozuar vlerësimi me 6 pikë.

Sa i përket kësaj statistike më duhet të sqarohet, duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistike për çështje të caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlogaritja e rendimentit sipas të dhënave që administrohen në dosje dhe për këtë është marrë i mirëqenë rendimenti 84.2% përcaktuar në raportin e vlerësimit të gjyqtarit në faqen 2350 të dosjes së rivlerësimit.

Në projektraportin e vlerësimit, duke pasur parasysh Metodologjinë e Pikëzimit, ku përcaktohet se gjyqtari që ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar, për gjyqtarin {...} rezulton se standardi sasior i punës është tejkaluar dukshëm më shumë se 50%, (duke qenë që ka qenë gjyqtar i shkallës së parë, i dhomës civile, si relator, i takonte të paktën jo më pak se 120 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare, ndërkohë që gjyqtari për vitin 2014 ka përfunduar 223 çështje me palë kundërshtare, pa përfshirë këtu kërkesat civile; për vitin 2015 ka përfunduar 208 çështje me palë kundërshtare, pa përfshirë këtu kërkesat civile dhe për vitin 2016 (deri në 08.10.2016) ka përfunduar 156 çështje me palë kundërshtare, pa përfshirë këtu kërkesat civile), prandaj aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është propozuar të vlerësohet një nivel më lart sesa ai që rezultonte nga statistikat, pra “Mbi 87-93%”.

Edhe për këtë tregues gjyqtari ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar se: “Vlerëson se do ishte mirë të mbahej parasysh që kjo statistikë ka në vetvete një faktor që nuk është vlerësuar siç duhet dhe që lidhet me çështjet e themelit që i shortohej gjyqtarit

në muajt e fundit të vitit, të cilat janë praktikisht të pamundura të përfundohen brenda këtij viti. Po ashtu duhet mbajtur parasysh që një kategori çështjesh kalojnë nga një gjyqtar në tjetrin për shkak të dorëheqjeve dhe kjo ndikon fiktivisht në statistikë, duke rritur numrin e çështjeve të vlerësuara si të pambyllura brenda vitit gjyqësor kur i kanë kaluar me short gjyqtarit. Po kështu, nuk reflektohet në projektvlerësim edhe delegimi në vitin 2014 për gjykimin e një çështjeje penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në mbështetje të kundërshtimeve, gjyqtari ka paraqitur vendimin e datës 07.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në cilësinë e relatorit, konsideroj që, së pari, nuk është bërë vetëm një përlllogaritje matematikore sepse po të kishte ndodhur kjo do duhet të ishte vlerësuar në një nivel më të ulët, pra 4 pikë dhe jo 6, nga ato që kam propozuar unë, dhe gjithashtu, duke shtuar edhe vendimin të cilin e ka paraqitur gjyqtari, sërish nuk mund të tejkalohet kufiri nga 87-93%. Prandaj, në kushtet kur nuk është bërë një vlerësim thjesht matematikor, por është bërë analizë logjike, propozoj që pikëzimi të mbetet 6 pikë.

Në lidhje me “Kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, shkalla e aftësisë konsiderohet më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategoritë të çështjeve, pikëzimi maksimal 15 pikë.

“Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, 1-3 seanca, pikëzimi maksimal 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 20 pikë.

“Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 10 pikë.

Në përfundim, për këtë tregues propozimi është për “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, nga 87 pikë që ishte propozimi fillestar, duke i shtuar edhe 3 pikë, gjyqtari shkon në pikëzimin 90 pikë dhe niveli i vlerësimit nga “Shumë mirë”, kalon në “Shkëlqyeshëm”.



Në lidhje me treguesin e tretë që ka të bëjë me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, sa i përket “Angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 35 pikë.

“Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 40 pikë.

“Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” është i pakonsiderueshëm, pikëzimi maksimal 15 pikë.

Në tërësi, për kriterin e “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, pikëzimi maksimal 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit të katërt që ka të bëjë me “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, në lidhje me “Komunikimin e qartë dhe transparent me kolegët”, shkalla e aftësisë konsiderohet “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 15 pikë.

“Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunuar me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale me ta”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 15 pikë.

Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 10 pikë.

“Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, është brenda kriterëve të përcaktuara nga ligji dhe pikëzohet maksimalisht me 20 pikë.

Në lidhje me “Disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, ka të dhëna për angazhimin e gjyqtarit, pikëzimi maksimal 5 pikë.

Sa i përket “angazhimit të gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, në kushtet kur u hartua projektraporti i vlerësimit nuk kishim të dhëna për këtë,

por gjyqtari në parashtresën e tij ka paraqitur prova në lidhje me angazhimin e tij dhe ka dhënë mendime konkretisht për sa i përket ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile, miratuar me ligjin nr. 114/2016 dhe ka paraqitur edhe provën përkatëse, komunikimin me zëvendëskryetaren e Kuvendit, sa i përket projektligjit konkret dhe gjithashtu rezultoi që në vitet 2014 dhe 2015 gjyqtari {...} është angazhuar si pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në procedurë civile, referuar kjo vërtetim të paraqitur nga gjyqtari me nr. {...} prot., datë 12.01.2017 të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë.

Në lidhje me “Publikimet ligjore akademike”, gjithashtu gjyqtari ka angazhimet e tij në këtë drejtim sa i përket publikimeve. Edhe për këtë propozohet pikëzimi maksimal prej 5 pikësh.

Në përfundim, për këtë kriter, duke qenë që nga propozimi fillestar që ishte për 98 pikë, duke i shtuar edhe 2 pikët sa i përket angazhimit të gjyqtarit për veprimtari ndërinstytucionale, atëherë në cilësinë e relatorit propozoj që gjyqtari për këtë tregues t’i akordohet vlerësimi maksimal prej 100 pikësh dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Në tërësi, për të katër kriteret, propozoj që gjyqtari të vlerësohet me 390 pikë, duke i shtuar 5 pikë nga propozimi fillestar, përfundimisht pikëzimi 390 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Muharremaj!

Fjalën do ia jepja magjistratit, shkurtimisht për çështje të cilat nga ana e relatorit nuk u reflektuan propozimet tuaja. Kështu që do doja që të ndalonit vetëm në ato çështje.

***{...}***: Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Jam dakord me parashtresën që bëri relatori.

Qëllimi i ardhjes time këtu ishte sepse dëshiroja vërtetë që të ndaja me ju disa vështirësi që shumica i dinë.

Në lidhje me përzgjedhjen e tre çështjeve me afat. Më janë vendosur një masë sigurimi dhe dy çështje civile. Në qoftë se shikohet statistika, masat e sigurimit të

përballuara në periudhën 3-vjeçare janë rreth 260 dhe është fakt i njohur që të gjitha masat e sigurimit bëhen brenda afatit 48 orë sepse nuk i shkel dot edhe po të duash, për shkak se ka pasoja ligjore. Ndërsa në rastin e çështjeve civile, sidomos në rastin e kundërshtimeve të veprimeve përmbarimore, ajo në thelb është një padi me ligjin e kohës dhe ka përplasje midis dispozitave, pra nga njëra anë duhet respektuar një afat 10-ditor minimal për të njoftuar palët për të marrë pjesë në seancë, nga ana tjetër duhet lënë patjetër një seancë përgatitore, pra, ja ku lihen dy seanca, në dallim nga ndryshimet që janë sot ose ligji që është sot në fuqi; dhe tjetra, pata rastin që duke pritur tek zyra e zotit {...}, për këtë seancë, pata mundësinë të dëgjoja edhe seancën pararendëse tuajën dhe njësoj siç edhe ju u konsultuat me njëri-tjetrin për datën e gjykimit pasardhës, e njëjta gjë behët edhe në seancë përgatitore. Nuk është se ke mundësi ta lësh datën e gjykimit ditën e nesërme sepse varet edhe nga palët. Pra gjithmonë konsultohesh me to. Kështu që afati 20-ditor në këto raste, është vënë nga ligjvënësi ndoshta duke pasur idenë që verifikimet do të bëheshin në dhomë këshillimi, por fatkeqësisht vetëm vonë u riparua kjo situatë.

E njëjta situatë edhe me çështjen tjetër për emërimin e përfaqësuesit ..., vërtetë ka një afat 10-ditor, por edhe ajo, po ta shikosh strikt në aspektin ligjor, bie ndesh me nenin 145 të Kodit të Procedurës Civile i cili thotë që seanca duhet t'i njoftohet palës të paktën 10 ditë përpara. Pra shohim këtu një përplasje, siç është edhe sot situata që do ju bie rasti ta shikoni në vlerësimet e mëpasshme për urdhrat e mbrojtjes. Ligji në gjykatën e apelit ka vendosur një afat 15-ditor për shqyrtimin e tyre në seancë me praninë e palëve dhe asnjë gjyqtar nuk e respekton dot këtë situatë sepse afati 15-ditor bie ndesh me parashikimin tjetër, që njoftimi i palëve duhet të bëhet me shpallje të paktën 2 javë përpara. Shtoji kësaj kohën që ha shorti, ardhja e dosjes. Domethënë janë situata që janë jashtë mundësisë objektive të gjyqtarit.

Këtë kisha dëshirë thjesht ta ndaja. Mund të them ndoshta edhe më shumë, por nuk dua t'ju ha kohë më tepër... Ju falënderoj!

*Naureda Llagami: Shumë faleminderit!*

**Brunilda Kadi:** Thjesht mora shkas nga deklaratimet në fund, në lidhje me përplasjet të cilat një pjesë janë korigjuar me ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Civile, por përsëri ka. Juve si një nga pjesëtarët e grupit të punës që keni draftuar Kodin e Procedurës Civile, keni insistuar që të korigjohesh kjo apo nuk ju dëgjuan tek grupi i punës?

{...}: Po t'ju tregoj debatet që kemi bërë...

Në fakt janë përmendur që ka edhe shumë momente të tjera përveç kësaj, ka shumë momente të tjera. Por në fakt, në këtë rast, për rastin që përmenda për urdhrat e mbrojtjes, ky problem nuk ka lindur nga Kodi i Procedurës Civile, por është ligji “Për masat kundër dhunës në familje” i cili ka vendosur afatin 15-ditor për shqyrtimin e këtyre çështjeve. Është një ligj i miratuar pa konsultim me njerëzit që punojnë çdo ditë me këto çështje. Ligjvënësi mund të vërë sa të dojë afate, të cilat sigurisht nuk kanë pasojë pavarësisht fatmirësisht, por mund ta kishte vënë ligjvënësi edhe një ditë shqyrtimin e këtyre çështjeve.

**Brunilda Kadi:** Domethënë problemi ka qenë tek grupi i punës tek ligji për Dhunën në Familje.

{...}: Nuk kam qenë.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo!

Problemi është i atij grupi pune.

{...}: Po, i atij grupi pune. Pra që nuk është konsultuar me pjesën që... (s’ dëgjohet fjala e gjyqtarit.)

**Naureda Llagami:** Diskutim tjetër/pyetje?

Nëse jo, faleminderit.

Për raportin tjetër ju nuk keni kundërshtime, kështu që do lejoni Këshillin që të vlerësojë mbi aktet.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

*(Del nga salla e mbledhjes gjyqtari {...}.)*

**Naureda Llagami:** Për të vijuar procedurën, do ndalemi tek çdo kriter dhe tek indikatorët nëse kemi sipas propozimit.

**Brunilda Kadi:** Përpara se të vijojmë, dua thjesht të sqaroj diçka me relatorin.

Për ta pasur të qartë, tek afatet ligjore, vetëm për tre raste kishte kundërshtuar gjyqtari, ato që i citoi?

**Erjon Muharremaj:** Po!

**Brunilda Kadi:** Dhe juve ato ia keni konsideruar dhe përsëri dilte tek ai nivel që propozuat?

**Naureda Llagami:** Ka ndryshuar niveli.

**Brunilda Kadi:** E di! E rriti një nivel. Nga 6 e çoi 9. Duke ia zbritur këto të tria?

Sa kishte edhe një herë të lutem? Sa ligjore kishte jashtë afatit, kundrejt të përgjithshmeve?

**Erjon Muharremaj:** Tre, dhe duke reflektuar ndaj kundërshtimeve që kishte bërë gjyqtari, mbetet një çështje jashtë afateve. Por duke qenë që paraprakisht e kisha ngritur një nivel më lart, nga ai që ishte, e kisha bërë edhe përpara se të dërgonte kundërshtimet gjyqtari, nuk ka ndryshim në kategorinë që ai duhet t'i përkasë referuar Metodologjisë.

**Brikena Ukperaj:** Ta sqaroj?

Gjyqtari ka pasur tre çështje me afat ligjor, nga të cilat vetëm dy i ka pasur jashtë afatit (një kundërshtim veprimesh përmbarimore dhe një caktim debitori). Pas pretendimeve janë analizuar dosjet, u panë datat e shortit, u panë datat e regjistrimit dhe përsëri rezultoni dosje jashtë afatit. Duke marrë parasysh natyrën e gjykimit të caktimit të përfaqësuesve, që ti duhet ta njoftosh dhe nuk e bën dot për 10 ditë, e ka zbritur Erjoni dhe ka mbetur 1 çështje që ka qenë “kundërshtim veprimesh përmbarimore”. Ajo çështje “kundërshtim veprimesh përmbarimore” është trajtuar pe padi, është caktuar seanca; është shtyrë një herë; është shtyrë edhe një herë për t’u njohur pala e paditur me provat. Kjo nuk mund t’i zbritet sepse ka kaluar dhe ka shkuar në 60 ditë. Kjo nuk i është zbritur.

**Brunilda Kadi:** Dhe në qoftë se i zbritet kjo, shkon 100%.

**Erjon Muharremaj:** Nëse kjo hiqet, -po! Nuk ngelet asnjë jashtë afatit pastaj.

**Brikena Ukperaj:** Ne kemi mbajtur qëndrimin që “kundërshtimet e veprimeve përmbarimore” duhet t’i gjykojnë brenda 20 ditëve dhe maksimumi brenda 45 ditëve. Por e ka kaluar gjyqtari atë.

**Brunilda Kadi:** Edhe për gradimin?

**Brikena Ukperaj:** Edhe për gradimin.

Edhe në atë kohë 20 ditë e parashikonte ligji.

**Brunilda Kadi:** Tani e qartësoi që bëhet në dhomë këshillimi dhe është ndryshe.

**Brikena Ukperaj:** Edhe në dhomë këshillimi nëse do ta bësh, je i detyruar që të marrësh praktikën përmbarimore. Sa do dojë të marrësh praktikën përmbarimore, se pala nuk ta sjell dot praktikën. Pala është gjithmonë debitore ose kreditore që do ta ankimojë këtë veprim.

**Brunilda Kadi:** Kur kemi mbajtur qëndrim neve që në këto veprimet përmbartimore i kemi ulur. Tek projektraportet që s'janë miratuar akoma.

**Brikena Ukperaj:** Në natyrën e gjykimit e kemi mbajtur parasysht, por në qoftë se ne do themi që kjo nuk duhet të gjykojë për 20 ditë, i bie që të gjitha kundërshtimet e veprimeve përmbartimore, zoti {...} kishte një, por një gjyqtar tjetër mund të ketë 10, dhe mund t'i ketë të 10-ta çështjet që vijnë në gradim. Duhet t'ia heqim dhe të prezumojmë që ka zbatuar afatin ligjor.

**Naureda Llagami:** Kemi propozim konkret Bruna?

**Brunilda Kadi:** Jo, nuk kam.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”. Nga ana e relatorit është propozuar 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Nuk dëgjohet vota e zonjës Luli.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Tek “Aftësitë organizative të gjyqtarit”.

**Erjon Muharremaj:** Pikët janë shtuar tek “Respektimi i afateve ligjore”, nga 6 në 9 pikë. Në total nga 87 pikë, në 90 pikë. Niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

**Naureda Llagami:** Jemi dakord me propozimin e relatorit?

**Maksim Qoku:** Nuk dëgjohet vota e zotit Qoku.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Nuk dëgjohet vota e zotit Hallunaj.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek indikator i radhës që është “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” ku propozohet 100 pikë nga relatori, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Atëherë jemi tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”. Fillimisht relatori ka propozuar 98 pikë. Tashmë e ka ndryshuar në 100 pikë, tek kriteri “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale”, nga propozimi fillestar 3 pikë, në 5 pikë. Jemi dakord.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.



***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë në total pikëzimi për katër kriteret është 390 pikë, niveli përfundimtar i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Dakord?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Ilir Toska*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019. Ia jap fjalën zonjës Ukperaj e cila shkurtimisht do t’i parashtrojë Këshillit gjetjet, duke marrë parasysh që magjistrati është dakord me rezultatin e propozuar.

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Gjatë periudhës së vitit 2019 gjyqtari {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, në seksionin civil.

Lidhur me vlerësimin e katër kriterëve që përbëjnë edhe vlerësimin total profesional të gjyqtarit, për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit” janë vlerësuar: “Njohuritë ligjore të gjyqtarit” – “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”; “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”; “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”; “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” dhe “Cilësia e analizës dhe e

argumentimit logjik”. Në të gjithë këto tregues gjyqtari propozohet të vlerësohet "Shkëlqyeshëm" me pikët totale 100 pikë.

Më tej, lidhur me analizën që është bërë, është e pasqyruar në projektraport, por nuk do të ndalem meqenëse edhe prej gjyqtarit nuk janë paraqitur kundërshtime.

Për sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarit”, “Respektimi i afateve ligjore”, në fakt, nga analiza matematikore e të dhënave statistikore ka rezultuar një përqindje 23% e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor e cila përkon me pikëzimin 9 pikë. Por duke bërë një analizë logjike të të dhënave burimore, ka rezultuar se gjyqtari si relator dhe si anëtar, ka gjykuar në total 276 çështje si relator dhe 447 çështje si anëtar. Referuar kësaj ngarkese pune, mendimit të kryetarit dhe vlerësimit të gjyqtarit, rezulton që numri i afatit ligjor ka qenë rreth 1/3 e totalit të çështjeve që ai ka shqyrtuar gjatë vitit 2019, prandaj për shkak të ngarkesës së punës, prej meje si relatore kam propozuar pikëzimi nga 9 pikë në 12 pikë. Nuk mund të shkonte gjyqtari në një pikëzim maksimal, pasi pavarësisht rrethanave objektive që lidheshin me kushtet e punës të prezantuara prej tij në formularin e integruar, duhet t’i kishte kushtuar më shumë rëndësi çështjeve me afat ligjor, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre duhet të gjykoreshin brenda afateve të arsyeshme (sikundër argumentohet), por brenda afateve të parashikuara shprehimisht nga ligji përkatës. Nga ana tjetër, volumi dhe rritja e papritur e çështjeve të pretenduara nga gjyqtari, nuk justifikon pikëzimin maksimal në këtë rast, pasi gjyqtari i apelit i nxjerr çështjet për gjykim sipas kalendarit të gjykimit, pavarësisht kohës së regjistrimit të çështjes në gjykatë. Në këtë kalendar çështjet për të cilat parashikojnë afate ligjore kanë përparësi krahasuar me çështjet e tjera, prandaj për këtë tregues kam vlerësuar që duhet të vlerësohet me 12 pikë dhe jo me pikët maksimale 15 pikë.

Referuar “Plotësimi të standardeve minimale kohore”, ka qenë vetëm 1.5 % e çështjeve jashtë standardit – vlerësimi maksimal.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, ka rezultuar më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe është propozuar pikëzim maksimal.

Lidhur me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”, ajo që është konstatuar, ka rezultuar nga një llogaritje matematikore një normë shumë e ulët e likuidimit të çështjeve nga gjyqtari gjatë vitit 2019, pasi rezulton të ketë pasur një

rendiment prej 57.6%. Pavarësisht këtij fakti që ka ndikuar në të dhënat që konsiderohen për efekt të llogaritjes së rendimentit, rezulton që gjyqtari ka përfunduar gjatë kësaj periudhe edhe më pak çështje sesa standardi minimal sasior, pra nuk ka përfunduar më shumë se 200 çështje civile themeli, nga 400 e ca çështje që ai ka gjykuar, vetëm 186 çështje kanë qenë civile themeli. Prandaj, referuar të dhënave kam vlerësuar si relatore që nga pikëzimi 2 pikë që ai duhet të merrte sipas analizës statistikore, referuar ngarkesës së punës, mund të justifikohet një shkallë pikëzimi deri në 4 pikë, por jo pikëzim maksimal apo ngritje në nivel tjetër sepse nuk rezulton që të jetë tejkaluar standardi minimal në fuqi, marrë parasysh edhe faktin që gjyqtari i apelit organizon dhe menaxhon vetë mënyrën e nxjerrjes së çështjeve për gjykim dhe nuk është i kondicionuar nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë.

Sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, të gjitha vendimet janë arsyetuar brenda afatit – është pikëzimi maksimal.

“Aftësia për të kryer procedura gjyqësore”, sa i përket numrit të seancave, ka rezultuar shumë i vogël (2,2) dhe gjyqtari i ka marrë të gjitha masat për zhvillimin me efektivitet të seancave gjyqësore. Seancat gjyqësore në apel, maksimumi kanë përfunduar me 1 ose 2 seanca.

Për sa i përket organizimit të procesit, evidentohet shkallë shumë e lartë në korrektësi dhe në planifikimin, mbikëqyrjes dhe zhvillimit të dokumentimit të veprimeve procedurale.

Edhe për sa i përket rregullshmërisë dhe dokumentacionit dhe saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit, gjyqtari është vlerësuar me vlerësim maksimal.

Përfundimisht, për kriterin e “Aftësive organizative”, është propozuar pikëzimi me 91 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Referuar kriterit të “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” dhe burimeve të vlerësimit, për të gjithë treguesit e këtij kriteri, të cilët janë pothuajse të njëjtë, ka rezultuar që gjyqtari ka shfaqur angazhim të lartë në funksion. Shkalla e integritetit lidhur me treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, është shumë e lartë. Nuk ka rezultuar përdorim i gjuhës diskriminuese. Numri i kërkesave

për përjashtim të pranuar është vetëm 2, pro asnjë prej tyre për shkak të konfliktit të interesit. Për këtë arsye është propozuar vlerësimi maksimal me 100 pikë.

Për sa i përket “Aftësive personale dhe angazhimit profesional të gjyqtarit”, për shkallën e komunikimit më palën, me administratën, dhe raportin me kolegët është vlerësuar maksimalisht.

Për sa i përket gatishmërisë së gjyqtarit në programet e formimit vazhdues, ka marrë pikët maksimale për sa i përket pjesëmarrjes në trajnime si dhe disponueshmërisë për të udhëhequr gjyqtarët gjatë stazhit profesional ose për trajnimin e gjyqtarëve, ka dhënë kontributin e tij si ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës.

Sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale është vlerësuar kontributi i tij në hartimin e akteve nënligjore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Është pasqyruar në projekt-raport.

“Publikimet ligjore akademike”, duke qenë se nuk ka pasur të dhëna, vlerësimi është me 0 pikë.

Për kriterin e katërt vlerësimi është 95 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Për të katër kriteret vlerësimi është "Shkëlqyeshëm" dhe pikët janë 386 pikë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj lidhur me prezantimin konciz të projektraportit!

Nëse kemi diskutime nga kolegët mbi propozimin e ardhur nga relatori?

Atëherë, jemi dakord me propozimin e relatorit në tërësi, meqenëse edhe magjistrati nuk pati kundërshtime.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, në total për magistratin kemi 386 pikë, dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit është “Shkëlqyeshëm”.

Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\*Anëtarë e Këshillit bëjnë disa minuta pushim, për t’u rikthyer sërish me zhvillimin e mbledhjes nëpërmjet platformës “online”.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Ilir Toska.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Viojmë me çështjen e radhës së rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe që do relatohet nga zoti Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Më herët, me vendimin nr. 158, 14.04.2021 nga ana e Këshillit është hapur procedura e transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe njëkohësisht janë tërhequr edhe kërkesat në lidhje me gjyqtarët të cilët do të shprehin interesin për t’u transferuar në këtë gjykatë.

I vetmi i cili ka shprehur interesin është zoti {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, i cili i është drejtuar KLGJ-së me kërkesë, duke shprehur

njëkohësisht edhe shprehjen e interesit për transferimin e përkohshëm me pëlqim pranë kësaj gjykate (rrethi Kukës).

Në vijim, kam paraqitur në mënyrë të detajuar eksperiencën e zotit {...} në sistemin gjyqësor, kështu që nuk po ndalem në të.

Në kuptim të nenit 46 të ligjit 96/2016, të nenit 8, të Vendimit të Këshillit nr.23, datë 07.02.2019 u tërhoq edhe opinionin e zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të cilës iu kërkua opinion lidhur me ngarkesën e gjykatës të cilën drejton; pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në konsideratë efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Nuk po lexoj opinionin që ka dërguar zëvendëskryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, sepse është e gjatë. Shkurtimisht po marr një pasazh të vogël të saj, e cila shpreh opinion negativ në lidhje me këtë transferim.

“Ju bëjmë me dije se në total Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë në vitin 2020 ka gjykuar duke përfunduar me vendimmarrje 580 çështje gjyqësore. Një pjesë e konsideruar e tyre kanë qenë çështje penale, nga ku përafërsisht për gjysmat e tyre konsumohen minimalisht tre gjyqtarë, duke filluar në fazën e gjyqtarit të hetimeve paraprake, gjyqtari i seancës paraprake dhe gjyqtari i themelit. Fakti i transferimit të gjyqtarit në fjalë do të sillte si pasojë kërkesa të vazhdueshme nga ana e gjykatës drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për formim të trupit gjykues, dhe se nisur nga fakti se gjykata do të vijojë gjykimin e saj me një gjyqtar dhe mua zëvendëskryetare të gjykatës, e cila për shkak të çështjeve të shumta administrative do të cenonte në një farë mënyrë afatet e gjykimit.”

Kështu, duke marrë në konsideratë analizën/opinionin e dërguar nga zëvendëskryetarja e gjykatës në detyrë si dhe kriteret e kërkuara për transferimin dhe konkretisht faktin nëse: Transferimi i përkohshëm nuk cenon funksionimin e gjykatës ku kandidati ka caktimin e përhershëm; Dobia e transferimit të përkohshëm është më e madhe se efekti negativ që shkaktohet në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm; Kandidati nuk është i transferuar përkohësisht dhe as duke shërbyer në skemën e

delegimit; Kandidati nuk është nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të përkohshëm; Në rast të transferimit, kandidati nuk do të gjenden në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016; duke analizuar këto kritere, në mënyrë të veçantë po ndalem tek moscenimi i funksionimit të gjykatës.

Për sa i përket moscenimit të funksionimit të gjykatës ku kandidati ka caktimin e përhershëm, nga transferimi i përkohshëm, Komisioni ka në konsideratë numrin e gjyqtarëve sipas organikës së saj dhe atyre në detyrë në këtë gjykatë, sikundër edhe ngarkesën relativisht të ulët të tyre. Konkretisht, organika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është 4 gjyqtarë, ndërsa aktualisht në detyrë janë 3 gjyqtarë. Ndërkohë, ngarkesa aktuale e gjyqtarëve të kësaj gjykate, është në total 134 çështje, nga të cilat 46 çështje janë në lëndë penale. Pra, ngarkesa mesatare për gjyqtar e kësaj gjykate është afër 45 çështje për gjyqtar, ngarkesë kjo shumë e ulët në raport me ngarkesën e gjyqtarëve të gjykatave të tjera të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, përveçse shumë e ulët edhe në raport me standardin sasior të punës për gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm (400 çështje të natyrës kërkesa (civile ose penale) me ose pa palë të interesuara) referuar Vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010, të ish-KLD-së, që është pjesë e kuadrit nënligjor në fuqi për vlerësimin e gjyqtarëve sipas Vendimit nr.263, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Edhe në supozimin e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit të kësaj gjykate që ka dhënë pëlqimin, përsëri ngarkesa mesatare e punës për dy gjyqtarët në detyrë të saj mbetet e ulët (67 çështje për gjyqtar). Nga ana tjetër, edhe problematika që krijohet lidhur me gjykimin e çështjeve penale, ku sikurse referon në opinionin e saj negativ zëvendëskryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, kërkohej minimalisht tre gjyqtarë për të përmbyllur gjykimin e një çështjeje penale, tashmë është zbutur me ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës me Ligjin nr. 41/2021, që është botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 14.05.2021 dhe ka hyrë në fuqi më datë 29.05.2021. Sipas ndryshimeve që ka pësuar neni 332/dh i Kodit të Procedurës Penale, tashmë është e mundur që gjyqtari i seancës paraprake të shqyrtojë çështjen në themel në rastin kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit, si dhe

kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve. Nisur nga ky ndryshim, impakti i tij është në reduktimin e numrit të gjyqtarëve të domosdoshëm për të përmbyllur gjykimin e një çështjeje penale në raste specifike.

Në funksion të këtij mendimi, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, iu kërkua informacion statistikor për ngarkesën në lëndë penale, për vitet 2018-2020, i dërguar në rrugë postare më datë 07.06.2021. Sipas informacionit, numri i çështjeve penale të gjykuara ka qenë 212, nga të cilat, për 116 prej tyre, është proceduar me gjykim të shkurtuar. Pra, marrë parasysh këtë të dhënë, mund të supozohet se në më shumë se 50% të çështjeve penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, nuk do të jetë i nevojshëm gjyqtari i tretë, pra gjykimi tërësor i tyre mund të realizohet nga dy gjyqtarët në detyrë pranë saj.

Sa i përket dobisë më të madhe të transferimit të përkohshëm në raport me efektin negativ që shkaktohet në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm, Komisioni ka në konsideratë organikën e reduktuar të gjyqtarëve në detyrë (2) në gjykatën ku synohet bërja e transferimit të përkohshëm (Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës) dhe ngarkesën e lartë të punës së saj, ku sipas informacionit të kësaj gjykate, rezulton që janë të regjistruara për shqyrtim 333 çështje, kjo në raport me numrin e gjyqtarëve në detyrë dhe ngarkesën si më sipër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Nga të dhënat rezulton që kandidati i transferuar nuk bën pjesë në skemën e delegimit, nuk ka ndonjë masë disiplinore, gjithashtu në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale në kuptim të pikës 3 të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 ai ka bërë vetëdeklarimin dhe nuk rezulton të ketë një efekt të tillë negativ.

Gjithashtu, lidhur me përzgjedhjen e kandidatit që duhet të transferohet përkohësisht, Komisioni ka pasur në konsideratë edhe përcaktimet e pikës 3, të nenit 8, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm.

Kështu që, në përfundim, nga ana e Komisionit është përgatitur projektdrafti, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të vendosni përfundimisht:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për një periudhë deri në një vit.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.07.2021 (pasi është parashikuar një periudhë kohore 2-javore për të përfunduar gjykimin e çështjeve në fazën përfundimtare që ky gjyqtar duhet të ketë).

3. Përfundimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

5. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Alban!

Konkretisht propozimi për datën?

**Alban Toro:** Është data 01.07.2021.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për një periudhë deri në një vit.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.07.2021.
  3. Përjashtimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.
  4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.
  5. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.
- Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e tre anëtarëve në bordin drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë” (shtyrë nga mbledhja e datës 18.03.2021).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |



*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Ilir Toska.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e tre anëtarëve në bordin drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë” (shtyrë nga mbledhja e datës 18.03.2021).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e radhës e rendit të ditës e cila është një çështje të cilën ne e kemi shtyrë nga mbledhje e mëparshme, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e tre anëtarëve në bordin drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.

Siç jeni në dijeni, në mbledhjen e Këshillit, me propozimin e zotit Toro por edhe me miratimin nga Këshilli, u vendos që neve së pari të përcaktonim, që personat që do të përfshiheshin si anëtarë të Bordit Drejtues, të mos ishin vetëm IT të gjykatave por edhe persona nga sistemi gjyqësor (gjyqtarë). Në përgjigje të shkresës sonë, pasi edhe nga ana e të dy projekteve u asistua lidhur me definicionin që kishte përdoruesi fundor, dhe jeni vënë në dijeni mbi aktet dhe kuptimin e këtij definicioni të përdorur në VKM-në e qendrës; nga ana e stafit është komunikuar me të gjithë gjykatat dhe u mbledhën edhe një herë të dhënat për kandidatët e mundshëm që mund të jenë anëtarë në këtë Bord, dhe ju

kemi përcjellë një relacion lidhur me emrat konkret dhe kemi bërë një renditje lidhur me eksperiencën që kanë, që do të thotë eksperiencën e secilit gjyqtar në përdorimin e sistemit.

Megjithatë, për më shumë detaje unë do ftoja zotin Greca, i cili do të detajojë lidhur me listën e gjyqtarëve, kancelarëve që ne kemi në dispozicion për të përzgjedhur anëtarë nga ana e KLGJ-së, në Qendrën e Teknologjisë.

***Kelment Greca: Përshëndetje, të nderuar anëtarë!***

Po e nis këtu ku e ka Kryetarja. Në përfundim të procedurës është mbledhur informacioni. Nga gjykatat janë propozuar në total 41 kandidatura, duke përfshirë kandidatët IT të propozuar në fillim si dhe kandidatët e propozuar sipas përkufizimit të zgjeruar.

Ndarja e kandidatëve sipas funksionit është si më poshtë:

Janë 10 kandidatë me funksion gjyqtar, nga të cilët një është në funksion si kryetar i gjykatës; 4 kandidatë me funksion kancelar; 1 kandidat me funksion ndihmës ligjor; 23 kandidatë IT; 2 kandidatë kryesekretarë dhe 1 kandidat që është IT, që mbulon edhe fushën e të drejtës së informimit.

Nga Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk është propozuar asnjë kandidaturë, ndërsa nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë propozuar 2 kandidatura: znj. {...} (kryesekretare) dhe z. {...} (specialist IT). Kandidaturave i është kërkuar jetëshkrimi, në të cilin rezulton që zonja {...} ushtron funksionin e kryesekretares që nga viti 2011, ndërsa ka ushtruar më parë detyrën e sekretares gjyqësore nga 2006-2011. Kurse kandidati {...} ushtron funksionin e IT-së nga viti 2021. Është emëruar me procedurat e pranimit jashtë shërbimit civil gjyqësor dhe për këtë shkak nuk gëzon statusin e nëpunësit civil gjyqtar.

Ndërsa nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm në të gjitha shkallët, janë propozuar kandidatë gjyqtarë, kancelarë, ndihmës ligjorë dhe kryesekretarë.

Në lidhje me përzgjedhjen e anëtarëve të propozuar në mbledhjen plenare të datës 13, janë renditur sipas vjetërsisë dhe eksperiencës që kanë si përdorues të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve.

Në total, 10 kandidatura me funksionin gjyqtar, të radhitur më poshtë:  
{...}, i propozuar nga Gjykata e Apelit Administrativ (19 vjet).  
{...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (18 vjet).  
{...}, kandidatë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (16 vjet), plus 2 vjet si Inspektor në ish-KLD.

{...}, propozuar nga Gjykata e Lezhës (15 vjet).  
{...}, propozuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (14 vjet).  
{...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (14 vjet).  
{...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (8 vjet).  
{...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (7 vjet).  
{...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec (1 vit).  
{...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë (1 vit).

Sa i përket kancelarëve, janë propozuar 4 kandidatura.

Nga gjykatat e apelit janë propozuar: {...}, Gjykata e Apelit Tiranë (8 vjet).  
{...}, Gjykata e Apelit Durrës (5 vjet).  
Nga shkallët e para janë propozuar {...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (10 vjet).  
{...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (7 vjet).

Kancelari, si aktor i rëndësishëm në proceset administrative në përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, do të jetë një vlerë e shtuar në kontributin e nevojshëm të Bordit. Kancelari ushtron funksionet të parashikuara në nenin 39 të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku ndër të tjera parashikohet se: “Pas këshillimit me kryetarin e gjykatës, kancelari është përgjegjës për: a) funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit dhe mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të saktë të të dhënave; b) dorëzimin e raporteve periodike për gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve Këshillit të Lartë Gjyqësor;”

Kancelari, si personi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mirëpërdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjes, por edhe si anëtar me të drejtë vote në Këshillin e Gjykatës, luan

një rol të dyfishtë dhe vlerësohet pozicioni i cili është në dizenjimin të plotë të aspekteve praktike dhe problematikave që lindin në gjykata nga përdorimi i sistemeve elektronike.

Kandidatë të tjerë jashtë funksionit të gjyqtarit e kancelarit për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm janë:

{...} - Ndihmës ligjor – 6 vjet- Gjkata e Apelit Korçë (aktualisht në proces vetting-u).

{...} - Kryesekretare - 3 vjet - Gjkata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjatë përzgjedhjes së anëtarëve mbahet në konsideratë eksperiencia profesionale në funksionin përkatës, si dhe rëndësia dhe volumi i punës i gjykatës ku kandidatët ushtrojnë funksionet.

Gjithashtu, vlerësimi me përparësi i kandidatëve të cilët ushtrojnë detyrat në qytetin e Tiranës, do të lehtësojë pjesëmarrjen dhe ushtrimin e funksioneve të anëtarit të Bordit.

Në përfundim, Këshilli duhet të zgjedhë një përdorues fundor propozuar nga Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe 2 përdorues fundorë të propozuar nga gjykatat e tjera të shkallëve të ndryshme. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Do ftoja kolegët të bënin propozimet përkatëse.

**Alban Toro:** Mundem?

**Naureda Llagami:** Po Alban!

**Alban Toro:** Faleminderit!

Paraprakisht më duhet të falënderoj të dy misionet për shpejtësinë me të cilën trajtuan kërkesën time dhe njëkohësisht për kontributin që dhanë në unifikimin e nocionit "përdorues fundor". Më tej, pas një parashtrere të vogël, do t'ju bëj dy propozime. Nëse do të kalohet i pari, mund të kalojmë tek i dyti.

Gjithsesi, më lejoni të parashtoj që i gjithë ky sistem teknologjik do të jetë në fundit të fundit në dispozicion të gjyqtarit, i cili ka përgjegjësinë që jo vetëm të shpalli

vendimet por nga ana tjetër ta bëjë të jetë sa më transparent në të gjithë aktivitetin e tij dhe kjo gjë do t'i shërbejë atij dhe aktivitetet të cilët ai ka dhe do të kryejë. Kështu që, duke u nisur edhe nga kompozimi i Këshillit i cili është harmonizuar me gjyqtarë dhe jo gjyqtarë, unë do të sugjeroja dhe do të propozoja që ndoshta ky kompozim të ishte edhe në infrastrukturën më të lartë të sistemit teknologjik, pra në këtë drejtori, që tre komponentët të cilët ne kemi për detyrë të propozojmë, të jenë nga gjyqësori.

Në hipotezën që ky variant do të pranohet edhe nga kolegët, pra që të tre anëtarët të jenë gjyqtarë, nga emrat e gjyqtarëve të cilët kemi të listuar në relacion, do të...

*Naureda Llagami:* Alban, vetëm për saktësi, përpara se të dalim tek pjesa e propozimit, kemi një merak, sepse për Gjykatën e Posaçme VKM-ja na ka detyruar që të kemi një përfaqësues nga gjykatat e posaçme dhe ato gjykata nuk na kanë përcjellë gjyqtarë, kemi vetëm staf teknik/staf administrativ. Kështu që, në qoftë se për gjykatat e tjera mund të jemi tek versioni që mund të kemi gjyqtarë, këtu, me atë që ka përcjellë gjykata, me gjithë kërkesën e ribërë nga ana jonë, ka qenë për stadin teknik, dhe besoj Keli e tha.

*Brunilda Kadi:* Kemi {...} nga gjykata e posaçme kandidat.

*Alban Toro:* Edhe sikur të mos të jetë {...}, ata kanë të drejtë të bëjnë propozime. Që do të thotë, në kushtet dhe në eventualitetin që ata nuk bëjnë propozime, në fund të fundit vendimmarrjen do ta marrë Këshilli për emrat që do të caktojë në atë drejtori. Kështu që, nuk është se është i detyrueshëm propozimi i tyre sepse ai që vendos në fund është Këshilli, i cili për shumë aspekte mund të vlerësojë që anëtari të jetë nga radhët e gjyqtarit apo nga radhët teknik, etj., etj.

Gjithsesi, ndoshta, nëse do donim ta ndanim, pra të fiksojmë faktin nëse duhet të jenë të gjithë gjyqtarë dhe më pas të vijojmë me identifikimin e gjyqtarëve, ok! - nuk ka problem dhe unë e ndërpres këtu. Për çështje kohe mendova që të kaloja tek propozimi i dytë, që nga ana ime do të ishte për gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} (të paktën më duken

aktiv në pjesëmarrjet e tyre në shumë forume por edhe në aktivitete gjyqësore).  
Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Atëherë, ndonjë propozim tjetër?

*Brikena Ukperaj:* Zonja Kryetare, Brikena!

*Naureda Llagami:* Po, Brikena!

*Brikena Ukperaj:* Së pari, dua të theksoj lidhur me termin “përdorues fundor”, edhe unë jam dakord me propozimin që kanë bërë misionet lidhur me kuptimin e këtij termi, janë të gjithë subjektet/aktorët që marrin dhe që përdorin sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve. Por sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk është sistem në dobi të gjyqtarit. Në ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore, referuar ligjeve procedurale, në asnjë moment nuk thuhet që gjyqtari duhet të përdorë sistemin në fakt. Futja e sistemit elektronik është bërë me qëllim që të kemi një transparencë të ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, duke filluar nga mënyra e regjistrimit të çështjeve, nga mënyra e shpërndarjes së çështjeve, nga dokumentimi i veprimtarisë gjyqësore, dhe ajo që është më e rëndësishme dhe që ne vuajmë sot është prodhimi i statistikave gjyqësore në rrugë elektronike, pra nëpërmjet sistemit.

Gjyqtari është një nga përdoruesit e sistemit, por jo më pak të rëndësishëm në përdorimin e sistemit janë kancelarët dhe kryesekretarët. Në qoftë se ata nuk do të hedhin siç duhet punën e tyre, gjyqtari nuk ka se çfarë të dokumentojë dhe të hedhë në sistem. Jemi të ndërgjegjshëm që sistemi sot, në fakt, përdoret më shumë nga kryetarët e gjykatave, nga kancelarët dhe nga kryesekretarët. Shumica e gjyqtarëve nuk e punojnë sistemin por janë sekretaret gjyqësore që hedhin të dhënat në sistem dhe duke u futur edhe tek ato rubrika të posaçme të cilat janë për gjyqtarin.

Duke u nisur nga kontributi real dhe nga shkalla e përdorimit të sistemit nga secili nga këta subjekte, unë vlerësoj që: nga VKM-ja detyrohemi që duhet të kemi tre përfaqësues (një duhet të jetë nga gjykatat e posaçme, dhe dy duhet të jenë nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm), duke marrë parasysh që kemi një përfshirje të të gjithë

aktorëve në këtë Bord, dhe njëkohësisht të kemi mundësi që të marrim kontributin real edhe të tyre, pra duhet të dëgjohet edhe kancelari edhe kryesekretari, të kishim një shpërndarje të barabartë; pra të kishim një përfaqësues nga gjyqtarët, një përfaqësues nga kancelarët dhe një përfaqësues nga kryesekretarët. Janë të tre aktorë shumë të rëndësishëm të përdorimit të sistemit sot. Prandaj, duke marrë parasysh propozimin e ardhur nga gjykatat e posaçme, jam dakord me zonjën që është kryesekretare në gjykatën e shkallës së parë të posaçme për t'u bërë pjesë e qendrës, dhe duke ndarë një gjyqtar dhe një kryesekretar, zonja {...} që është nga kancelarët dhe që është renditur më lart për sa i përket vjetërsisë së saj në profesion. Për sa i përket gjyqtarëve, në vlerësimin tim, kontributi i gjyqtarit si kryetar gjyqtare është imput shumë i mirë edhe për Bordin e Qendrës së Dokumentimit të Teknologjisë së Informacionit. Prandaj unë do të propozoja që, duke marrë parasysh që zoti {...} është gjyqtari që ka vjetërsinë më të madhe në profesion por edhe kontributin e tij real si kryetar i gjykatës, i cili përdor sistemin më shumë se çdo gjyqtar tjetër, të ishte ai. Propozoj zotin {...}, zonjën {...} dhe zonjën tjetër që është kryesekretare e gjykatës së posaçme. Faleminderit!

***Brunilda Kadi:*** Mundem Kryetare?

***Naureda Llagami:*** Po Bruna!

***Brunilda Kadi:*** Atëherë, pa propozuar emra konkretë, unë dua të mbështes argumentet e Albanit dhe disi të kundërshtoj një pjesë të asaj që u theksua nga Brikena. Është e vërtetë që gjyqtarët nuk janë përdoruesit praktikë që hedhin të dhënat në sistem, se kjo është afër mendsh që nuk është gjyqtari që bën këtë pjesë. Por në fund të ditës, qendra është në funksion të asaj që kemi vite që po e themi dhe po përpiqemi ta realizojmë, pasja e një sistemi gjyqësor eficient dhe transparent. Këto janë përgjegjësi në fund të ditës të gjyqtarit, jo të sekretarëve, as e kryesekretarëve dhe as e kancelarëve.

Një qendër kaq e rëndësishme që për mua është Bordi më i rëndësishëm, ndoshta më i rëndësishmi në gjithë menaxhimin e sistemit të drejtësisë, të ketë vetëm një magjistrat, më duket e papranueshme, kur magjistrati është ai që mban përgjegjësi për

sistemin e drejtësisë. I mëshoj fort që të paktën tre anëtarët që kemi në mundësi t'i zgjedhim, duhet të jenë gjyqtarë.

Për sa i përket shpërndarjes dhe detyrimit, zoti {...} e plotëson kushtin. Ai është gjyqtar i skemës së delegimit në gjykatën speciale. Për dy gjyqtarët e tjerë, nuk kam asgjë kundër me zotën {...}, mund të jetë edhe ai, por duke qenë se (nuk duam të parashikojmë asnjë gjë, as të urojmë të mirën, as të keqen) ai është në proces të papërfunduar të rivlerësimit (do të uroja që ta kalonte me sukses në fakt gjithsesi) por duke mos e ditur rezultatin, nëse ndodh diçka jo e mirë, të mos rimblidhemi dhe të vendosim një emër tjetër (nuk ndodh gjë nga e thëna).

Ndoshta, dy gjyqtaret që propozoi Albani, duke qenë që i përkasin të njëjtës gjykatë, mund të mos jenë të dyja propozim, të jetë një nga juridiksioni i përgjithshëm ose nga një juridiksion tjetër. Jam e hapur për propozime të tjera. Por që të tre anëtarët duhet të jenë gjyqtarë, për mua kjo nuk duhet të ketë diskutim. Faleminderit!

**Medi Bici:** Mediu zonja Kryetare!

**Naureda Llagami:** Po, zoti Bici!

**Medi Bici:** Unë nuk kam ndonjë kundërshtim për propozimet që bën Albani, por mendoj që ndarja është e padrejtë sepse të dy përfaqësueset vijnë nga e njëjta gjykatë, duke përjashtuar zotën {...} që jemi të detyrueshëm. Mendoj që një përfaqësues duhet të jetë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe tjetri duhet të jetë nga Gjykata e Apelit Administrativ.

**Naureda Llagami:** Propozim tjetër?

Atëherë, kemi dy qëndrime. Kemi një qëndrim në fakt gjithëpërfshirës i cili thotë që për tre pozicione që ka Këshilli, të ketë mundësi të çojë të gjithë nivelet që punojnë në administratën gjyqësore, përfshirë gjyqtarin, përfshirë kancelarin, përfshirë edhe kryesekretarin. Mos harrojmë që Këshilli i Lartë Gjyqësor tashmë, për herë të parë, i ka të gjithë këto nivele dhe janë nën përgjegjësinë e Këshillit.



Kurse, propozimi tjetër, është që të jenë tre gjyqtarë, pa hyrë tek emrat konkretë sepse në fakt nuk doja që të hyja në emrat konkret, pavarësisht procedurave që kanë emrat konkret, sepse kur fillojmë bëjmë në këtë diskutim, kjo nuk është pozitive. Do preferoja të hynim në kritere objektive në fakt dhe të thoshim sa vite keni gjithsecili në sistem dhe çfarë punë bën gjithsecili. Dhe jo të hyjmë në emra, nëse jemi në proces vetting-u apo s'jemi në proces vetting-u dhe kush janë pritshmëritë. Në fakt kjo nuk i takon Këshillit, për rolin që ka t'i bëjë këto vlerësime.

Megjithatë, meqë u bënë, unë do doja që ta ndanim votimin në dy kategori: i) në kategorinë gjithëpërfshirëse dhe ii) në kategorinë vetëm gjyqtarë; më pas pastaj le të kalojmë në emrat konkret.

**Brunilda Kadi:** Mundem Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po?!

**Brunilda Kadi:** Së pari, ju është tërhequr edhe një herë tjetër vëmendja nga një anëtar, juve nuk jeni në rolin e mësuesit aty ku po flisni, jeni anëtar si unë. Nuk mund të më tregoni mua se çfarë duhet të flasë dhe çfarë s'duhet të flasë. Edhe nuk mund t'i tregoni Këshillit se me çfarë forme duhet ta ndajë votimin. Ju mund të bëni propozimin tuaj konkret dhe të hidhet në votë, siç hidhet propozimi im, apo i Albanit, apo i Brikenës, apo i Mediut. Se është ngatërruar shpesh ky pozicioni juaj. Flisni sikur të jeni mësuesja e Këshillit, sikur i vendosni ju rregullat e votimit, sikur orientoni ju Këshillin si duhet të votojë. Bëni propozimin konkret. Jepe propozimin konkret ta votojmë.

Naureda Llagami: Besoj e kuptove kaq Bruna, që propozimi im konkret ishte që mbështes qëndrimin e zonjës Ukperaj, jo për emrat konkret në fakt, por për pozicionet.

Siç jep ti mendimin dhe kushdo këtu në Këshill, unë si Kryetare, pa diskutim që do e jap vlerësimin tim dhe këtë s'ma kufizon jo ti, po asnjëri këtu.

**Brunilda Kadi:** Jo si Kryetare! Mund ta japësh si anëtare. Si Kryetare nuk e ke atë kompetencë.

**Naureda Llagami:** Një sekondë Bruna, se s'të ndërpres asnjëherë.

Kujdes me etikën, se nuk të ndërpres. Respekto gjithsecilin kur flet këtu! Ke për të detyrë të më respektosh kur mbaroj fjalën unë, pastaj fillo ti.

**Brunilda Kadi:** U duk që mbaroi diskutimi juaj.

**Naureda Llagami:** Jo, nuk u duk Bruna.

Kur mbaroj, do mbaroj dhe e mbyll unë kur mbaroj.

**Brunilda Kadi:** Ti je Kryetare për pjesën administrative. Nuk drejton Këshillin si Kryetare se si do votojmë.

**Naureda Llagami:** Nuk e thashë që të drejtoja Këshillin, thashë për pjesën e gjithëpërfshirjes. Dhe këtë merak e ngrita që në fillim, meqë jemi Këshill dhe nuk jemi vetëm Këshill (dhe këtu është mendimi dhe vlerësimi im dhe bashkohem këtu me Brikenën) i gjyqtarëve Bruna, por jemi Këshilli i të gjithëve, jemi edhe i kancelarëve, jemi dhe i sekretarëve; dhe kemi bërë gjithë këto reforma në fakt.

Megjithatë, fillojmë me propozimet konkrete që keni dhe atë që ju ofrova ishte që mos të dalim dhe të fillojmë me kriteret objektive. Ky ishte shqetësimi im.

**Brunilda Kadi:** Dhe ku t'u duk që neve nuk kishim kriteret objektive kur bëmë propozimet konkrete? Sepse edhe zonja Ukperaj me propozim konkret doli. Me emra konkret doli.

**Naureda Llagami:** Nuk dua të jap përgjigje sepse nuk kam për detyrë të jap përgjigje ty. Dhashë propozimin...

**Brunilda Kadi:** Mirë, nuk po ju pyes që të më jepni përgjigje. Mund të jetë pyetje retorike.

**Naureda Llagami:** Dhashë qëndrimin tim. Bruna, të lutem vazhdojmë hedhim në votim propozimet. Ky është qëndrimi im.

**Brunilda Kadi:** Po pra, por jo të korrigjosh qëndrimet e të tjerëve.

**Naureda Llagami:** Nuk kam korrigjuar.

Kam dhënë qëndrimin tim Bruna. Në qoftë se qëndrimin tim e sheh si korrigjim...

**Brunilda Kadi:** Nuk ke asnjë kompetencë si Kryetare të japësh qëndrim.

**Naureda Llagami:** Nuk kam kompetencë Bruna, kam qëndrim. Qëndrimi im vazhdon të mbetet i njëjtë, Këshilli përfaqëson të gjithë, përfaqëson edhe sekretarin, përfaqëson edhe kancelarin, të gjithë hallkat.

**Brunilda Kadi:** E nderuar Kryetare!

Qëllimi i zgjedhjes së anëtarëve nuk është që të punësojë njerëz. Qëllimi i saj është të çojë përfaqësues që përfaqësojnë sa më denjësisht dhe objektivisht dhe profesionalisht atë që duhet të përfaqësojnë në atë Bord aq të rëndësishëm, që nuk ka një gjyqtar deri tani. Se edhe ju nuk jeni gjyqtare, përfaqësoni, siç thoni, shoqërinë civile. Atëherë, kush do t'i përfaqësojë gjyqtarët aty, që janë ata që japin në fund llogari për sistemin e drejtësisë? Se kur përfliten gjyqtarët, nuk thuhet që e ka fajin sekretarja gjyqësore, as kancelari, por përmendet gjyqtari me emër dhe mbiemër. Prandaj është e rëndësishme që të jetë gjyqtari në atë Bord.

**Naureda Llagami:** Po ngatërrojmë funksionet.

Bruna, po flasim për përdorues të sistemit. Mund të jetë edhe këshilltar ligjor përdorues, mund të jetë edhe kryesekretari, mund të jetë edhe kancelari, mund të jetë edhe gjyqtari. Ajo që diskutojmë, nuk është se nuk duam gjyqtarë. E keqkuptove.

**Brunilda Kadi:** Nuk ka asnjë gjyqtar në atë Bord. Duhet të jetë edhe gjyqtar edhe prokuror.

**Naureda Llagami:** Po! Ka prokuror. Ka përfaqësues nga prokuroria. Do ketë përfaqësues, kur të shohësh VKM-në, nga të gjithë ...

**Brunilda Kadi:** Sipas mendimit tuaj, gjyqtar do ketë vetëm një anëtar në Komision.

**Naureda Llagami:** Jo, nuk të thashë që duhet të jetë vetëm një gjyqtar. Të thashë që në përfaqësimin tonë mund të jenë dy gjyqtarë, por t'i kemi të gjithë hallkat e sistemit, meqë kujdesemi për të gjithë.

**Brunilda Kadi:** Dhe me zotën {...} jam dakord.

**Naureda Llagami:** T'i kemi edhe kancelarët Bruna, meqë kujdesemi edhe për kancelarët, t'i kemi edhe sekretarët edhe kryesekretarët, edhe këshilltarët. Këtë po thosha.

**Brunilda Kadi:** Jo kancelari. Duhet të ketë gjyqtarë aty, që e kanë me Kushtetutë pavarësinë dhe të jenë zë i fort në atë Bord. Jo të jenë të lëvizshëm me një urdhër të thjeshtë nga puna, por të jenë gjyqtarë, që të kenë fuqi të flasin. Kjo është arsyeja pse duhet të ketë gjyqtarë në atë Bord.

**Naureda Llagami:** Bruna, tani mos të flasim of rekord ("of record") se sa gjyqtarët përdorin në krahasim me kancelarët, sa e përdor kancelari sistemin.

**Brunilda Kadi:** Zonja Kryetare, of rekords ("of records") unë nuk flas asnjëherë dhe ti e di shumë mirë këtë gjë.

**Naureda Llagami:** Ky është vlerësimi juaj dhe mua më vjen mirë që e bëni ju sepse ju bëni diferencimet në sistem. Unë që jam në shoqërinë civile, jam gjithëpërfshirëse, të jenë dhe të përfaqësohen të gjitha hallkat. Për mua, patjetër, roli i kancelarit është shumë kryesor. Për mua si Kryetare KLGJ-je të jetë një kancelar është shumë kryesore sepse bën procedura që ndoshta një gjyqtar që s'ka qenë edhe kryetar, nuk mund t'i dijë. Megjithatë, ky është mendimi juaj, do ta votojmë.

**Brunilda Kadi:** Zonja Kryetare, mendoj që ndoshta e kishit lapsus, thatë “unë si kryetare”. Nuk po diskutoni si Kryetare këtu. Tani po diskutoni si anëtare, njësoj si unë dhe njësoj si anëtarët e tjerë. Nuk ke asnjë kompetencë më shumë, përveçse kur votimi të dalë barazim dhe ju e ndani. Deri në atë moment ju jeni njësoj si anëtarët. Nuk mund të sugjeroni si Kryetare. Thoni mendimin tuaj si anëtare, si juriste.

**Naureda Llagami:** Si anëtare po ta them. Si anëtare e Këshillit, që përfaqësoj shoqërinë civile. Si Naureda Llagami po ta them.

**Brunilda Kadi:** Po jo si Kruyetare!

**Naureda Llagami:** Logjika ime është që këtu të kemi përfaqësim për herë të parë të tregojmë që si kancelari dhe gjyqtari janë njësoj për Këshillin. Kjo është logjika ime.

**Dritan Hallunaj:** Më fal se po ndërhyj!

A mundem fjalën një sekondë ju lutem?

Ju i dhatë të gjithë argumentet. Kush pati për të folur, secili ta shprehë me votë. A vazhdojmë me votimin?

**Naureda Llagami:** Atëherë kemi tre propozime:

Kemi propozimin e Albanit i cili propozon tre gjyqtarë: znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Kalojmë në votim.

**Brunilda Kadi:** Më falni për ndërhyrjen por mendoj që votimi duhet të hidhet një nga një për secilit nga emrat, se s'mund të votohen në bllok ata.

**Marçela Shehu:** Edhe unë jam dakord që votimi duhet të bëhet një nga një për shkak se për sa dëgjova dhe kuptova, zoti Bici ndante të njëjtin mendim me propozimin e Brunës dhe të Albanit, përveç pjesëmarrjes së një gjyqtari, që propozohej nga zoti Bici të ishte nga Gjykata Administrative e Apelit. Kështu që, për të konsideruar edhe propozimin e zotit Bici, unë vlerësoj që secili nga emrat e propozuar duhet të votohet një nga një.

**Brikena Ukperaj:** Zonja Kryetare, në fakt unë mendoj që ne duhet të biem dakord njëherë për përbërjen e personave që ne duhet të zgjedhim, do ta kemi gjithëpërfshirës apo do kemi vetëm gjyqtarë. Në varësi të kësaj pastaj do të dalim tek emrat konkret sepse nuk mund të votoj kundër një gjyqtari, ndërkohë që unë jam në thelb. Nuk e kam mendimin tim dhe kundërshtimet e mia lidhur me emrat konkret të gjyqtarëve, por me mënyrën dhe me përbërjen e personave që ne do të zgjedhim sot. Prandaj unë mendoj dhe vlerësoj të hedhim fillimisht në votë nëse do jetë përbërje vetëm nga gjyqtarë, pra do kemi vetëm tre përfaqësues gjyqtarë apo do kemi një përbërje gjithëpërfshirëse.

**Dritan Hallunaj:** Pikërisht unë këtë doja të thosha. Të zgjidhim formulën dhe pastaj në varësi të formulave përcaktojmë emrat.

**Fatmira Luli:** Propozimi i parë të jetë “të jenë gjyqtarë apo gjithëpërfshirës” – këtë të votojmë dhe pastaj kalojmë tek emrat.

**Naureda Llagami:** Këtë ju thashë që në fillim.

Atëherë, propozimi i parë:

Të jenë të gjithë gjyqtarë, po apo jo?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Kundër.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Kundër.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Kundër.

Kalojmë tani tek propozimi i gjyqtarëve me emrat konkret.

***Fatmira Luli:*** Të diskutojmë njëherë gjykatat nga vijnë dhe pastaj të kalojmë tek emrat.

***Naureda Llagami:*** Fatmira, kemi një listë ku janë renditur të gjithë emrat e gjyqtarëve sipas vjetërsisë që kanë në punë në gjykata.

***Fatmira Luli:*** Propozimi i Mediut ishte që të kemi nga të dy gjykatat. S'është e mirë që të ketë dy gjyqtarë nga një gjykatë. Jam dakord me propozimin e Mediut. Kështu që, do jetë mirë të propozonim nga gjykata e shkallës së parë, gjykata administrative dhe pastaj gjykata e posaçme është e detyrueshme sepse është e parashikuar në ligj.

***Brunilda Kadi:*** E bëjmë më të thjeshtë. Votojmë fillimisht zotin {...}, meqenëse i plotëson të dyja kushtet, është edhe gjyqtar, është edhe i vetmi kandidat nga gjykata speciale që ne kemi detyrimin ta zgjedhim. E kalojmë njëherë, që ta bëjmë më të thjeshtë pjesën tjetër.

***Naureda Llagami:*** Dakord jam me Brunën në fakt. Ta kalojmë fillimisht me zotin {...}. E hedhim në votim?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Kalojmë në propozimin e dytë. Kë sugjeroni për propozim të dytë?

**Brikena Ukperaj:** Vazhdojmë me Gjykatën e Apelit Administrativ sepse zoti {...} është edhe kryetar i kësaj gjykate. Të mos paragjykojmë ecurinë e procesit të vetting-ut.

**Brunilda Kadi:** Dakord jam edhe unë. Të vazhdohet me zotin {...}, meqenëse i plotëson të gjitha kushtet që ne kërkojmë. Të votohet ai dhe pastaj në qoftë se rrëzohet, të vazhdojmë me propozimet e tjera.

**Naureda Llagami:** Atëherë, propozohet zoti {...} (si kryetar i Gjykatës Administrative).

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.



Atëherë, kemi propozimin e tretë. Kemi një gjykatë të shkallës së parë (krimet e rënda), kemi Gjykatën Administrative të Apelit (që morëm përfaqësues) dhe kemi dy gjyqtarë që vijnë nga gjykata e shkallës së parë administrative.

**Brunilda Kadi:** Kam unë një propozim zonja Kryetare.

**Brikena Ukperaj:** Mund të them diçka përpara se të vazhdosh me emrin?

**Brunilda Kadi:** Ndoshta na përputhet ideja. Ta them unë, pastaj...

Atëherë, duke qenë se të dy gjyqtarët, njëri është në nivel apeli dhe kuptohet që është për të gjithë vendin - gjykatën speciale e zgjidhëm - mendoj që duhet të jetë nga gjykata e juridiksionit të përgjithshëm, shkalla e parë dhe nga rrethet (jo nga Tirana). Nisur edhe nga vjetërsia në punë, unë do propozoja zonjës {...} ose {...}.

Është gabim vjetërsia e zonjës {...} tek lista, ku thuhet 15 vjet. Duhet të jetë dikur tek 7-8 vjet zonja {...}, që është po njësoj si zonja {...}.

Për mua, cilindo nga këto dy kandidatura, do t'i propozoja që të hidheshin në votim.

**Brikena Ukperaj:** Zonja Kryetare, mundem?

**Naureda Llagami:** Po, Brikena!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, edhe unë mendoj si Bruna, që duhet të jetë një gjyqtar nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, por duke marrë parasysh zhvillimin e mbledhjeve të Bordit dhe përvojën profesionale të gjyqtarit {...}, propozoj zotin {...} nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është edhe i dytë në listën e renditjes. Pas zotit {...} është zoti {...}, sipas kriterëve objektive të vjetërsisë në profesion. Faleminderit!

**Marçela Shehu:** Kryetare, mundem?

**Naureda Llagami:** Po, Marçela!

**Marçela Shehu:** Unë bashkohem me propozimin e Brunës, që anëtari i tretë që përfaqëson gjyqtarët në Bord, të jetë një gjyqtar nga juridiksioni i përgjithshëm, nga rrethet gjyqësore dhe jo nga Tirana. Unë do propozoja zonjën {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (zëvendëskryetare e gjykatës).

**Naureda Llagami:** Atëherë, që mos shkojmë me tre propozime...

**Brunilda Kadi:** Unë tërhiqem dhe bashkohem me propozimin që sapo bëri Marçela për zonjën {...}. Nisur edhe nga argumenti shtesë që ajo është edhe zëvendëskryetare tashmë edhe në detyrë për shkak të situatës faktike në atë gjykatë, dhe mendoj që është një argument më shumë që do ishte pozitive që të ishte ajo në Bord.

**Naureda Llagami:** Atëherë, fillojmë me zonjën {...} si kandidaturë e tretë.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin e znj. {...} si anëtare e Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

2. Caktimin e z. {...} si anëtar i Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

3. Caktimin e z. {...} si anëtar i Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}z. {...} dhe z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Ilir Toska*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Duke u përpjekur që të jem shumë koncize në relatim, tashmë Këshilli dhe mbledhja plenare ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme fillimin e procedurave të

vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Në vijim të bashkëpunimit që kemi pasur me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit na janë dërguar tre dosje shtesë të tjera të gjyqtarëve që e kanë kaluar këtë proces dhe për të cilët vendimi ka marrë formë të prerë, që janë: z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Për shkak të trajtimit me përparësi të procesit të vlerësimit, pra të gradimit të këtyre gjyqtarëve, për shkak edhe të prioriteteve që ne kemi vendosur në programin e vlerësimeve të vitit 2021, Komisioni i Vlerësimit të Etikës i propozon sot mbledhjes plenare fillimin e procedurës së vlerësimit për të tre këta gjyqtarë për gradimin e tyre.

Lidhur me procedurën e shortit do të procedojmë në të njëjtën mënyrë siç kemi proceduar, duke filluar me përzgjedhjen e relatorit dhe të nëpunësit përgjegjës të vlerësimit sipas një barazie për ndarjen e punës që tashmë ne e kemi bërë zakon. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, stafi administrativ të mundësojë hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e parë të qelqit shiritat me emrat e gjyqtarëve: z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Futen në enën e dytë të qelqit shiritat me emrat e relatorëve: znj. Brikena Ukperaj, znj. Brunilda Kadi dhe z. Erjon Muharremaj.

Futen në enën e tretë të qelqit shiritat me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Gilda Hoxha, znj. Zeta Tërpollari dhe znj. Esmerilda Habili.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Tërhiqet emri i gjyqtarit të parë që i korrespondon znj. {...}.

Tërhiqet emri i relatorit të parë që i korrespondon z. Erjon Muharremaj.

Tërhiqet emri i nëpunësit përgjegjës të parë që i korrespondon znj. Esmerilda Habili.

Tërhiqet emri i gjyqtarit të dytë që i korrespondon znj. {...}.

Tërhiqet emri i relatorit të dytë që i korrespondon znj. Brikena Ukperaj.

Tërhiqet emri i nëpunësit përgjegjës të dytë që i korrespondon znj. Gilda Hoxha.

Tërhiqet emri i gjyqtarit të mbetur në enë që i korrespondon z. {...}

Tërhiqet emri i relatorit të mbetur në enë që i korrespondon znj. Brunilda Kadi.

Tërhiqet emri i nëpunësit përgjegjës të mbetur në enë që i korrespondon znj. Zeta Tërpollari.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Zeta Tërpollari.

2. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

3. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** 7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Ilir Toska.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjet e tjera të rendit të ditës të cilat kanë të bëjë me përsëritjen e transferimit për tre gjyqtarë në dy gjykata. Gjykata e para është Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Me vendimin nr. 233, datë 02.06.2021, nga ana e Këshillit është proceduar me hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës për një afat deri në 1 vit dhe njëkohësisht i është drejtuar gjyqtarës në detyrë {...} për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

Në këtë kuadër, gjyqtarja Paja ka depozituar pëlqimin për vijimin e transferimit, kështu që në bazë të nenit 46 të ligjit 96/2016 si dhe nenit 8 të vendimit nr. 23, datë

07.02.2019 është proceduar për të tërhequr opinionin e zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet në lidhje me ngarkesën e gjykatës të cilën drejton; pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës; si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në konsiderate efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Zëvendëskryetarja në detyrë e kësaj gjykate ka shprehur mendimin se transferimi i përkohshëm i këtij gjyqtari nuk krijon problematika në ngarkesën e çështjeve për gjyqtar dhe gjykimin e çështjeve brenda afatit të arsyeshëm, përveç problemit të delegimit të gjyqtareve nga gjykatat e tjera për gjykimin e çështjeve penale.

Kështu që, duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtarës që ka shprehur pëlqim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, fushën e së drejtës (specifike) që mbulon në këtë gjykatë në nevojë, cenimin e funksionimit normal, marrë në konsideratë jo vetëm organiken aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistencën e pozicionit të lirë të përkohshëm në të, ngarkesën aktuale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet ku ajo është caktuar në mënyrë të përhershme, përfundimin e afatit të transferimit (zgjatjes) të përcaktuar me Vendim nr. 203, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga ana e Komisionit është përgatitur projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju propozohet të miratoni: 1. Gjyqtarës {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 22.06.2022.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Durrës

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim për projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij.

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Brunilda Kadi*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e përsëritjes së transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Ilir Toska.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me propozimin për përsëritjen e transferimit për gjyqtarin {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Për më shumë detaje, prapë fjalën ia jap zotit Toro.

*Alban Toro:* E njëjta situatë e ngjashme. Edhe për këtë gjykatë, më herët, me vendimin nr. 234, 02.06.2021, nga ana e Këshillit është proceduar për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një afat 1 vit. Gjithashtu është ftuar zoti {...} për të dhënë pëlqim për përsëritjen e transferimit të përkohshëm. Nga ana e këtij gjyqtari është depozituar pëlqimi.

Konform nenit 46 të ligjit 96/2016 dhe nenit 8 të vendimit nr. 23, datë 07.02.2019 është kërkuar edhe opinioni i zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me ngarkesën e gjykatës të cilën drejton në përgjithësi; pasojat që krijohen për

gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në konsiderate efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Në mënyrë të detajuar është paraqitur ky opinion. Zëvendëskryetarja e ka lënë në çmim të KLGJ-së vlerësimin në lidhje me këtë çështje. Kështu që, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, duke pasur parasysh që nuk mund të aplikohet zbatimi i nenit 45, 46 të ligjit nr. 96/2016, verifikoi kriteret e kandidaturës që ka dhënë pëlqim.

Në përfundim, duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtarit që ka shprehur pëlqimin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, fushën e së drejtës (specifike) që mbulon në këtë gjykatë në nevojë, cenimin e funksionimit normal, marrë në konsideratë jo vetëm organikën aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistencën e dy pozicioneve të lira të përkohshme në të, ngarkesën aktuale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme, përfundimin e afatit të transferimit (zgjatjes) të përcaktuar me Vendim nr. 205, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ju është propozuar të ripërsëritet transferimi i përkohshëm për këtë gjyqtar, duke ju paraqitur edhe projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni: 1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 22.06.2022.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, hedhim në votim projekt-aktin.

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.06.2021)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 13:54.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Ilir Toska.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Për më shumë detaje, sërish ia jap fjalën zotit Toro.

*Alban Toro:* Po flasim përsëri për të njëjtën situatë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ku më parë janë transferuar dy gjyqtarë, një nga të cilët sapo e miratuar për t’i vijuar transferimi i përkohshëm.

Me vendimin nr. 234, 02.06.2021, nga ana e Këshillit është proceduar për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, dhe është ftuar zonja {...} për të dhënë pëlqim për përsëritjen e këtij transferimi. Nga ana e kësaj gjyqtareje është depozituar pëlqimi përkatës. Kështu që, në vijim është proceduar me tërheqjen e opinionit të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat në lidhje me ngarkesën e gjykatës të cilën drejton; pasojat që krijohen për

gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtarja kërkohet të transferohet.

Të njëjtën procedurë ka ndjekur edhe kjo kryetare, e cila e ka lënë në çmim të KLGJ-së vendimmarrjen në lidhje me këtë pjesë. Kështu që, duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtares që ka shprehur pëlqim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, fushën e së drejtës (specifike) që mbulon në këtë gjykatë në nevojë, cenimin e funksionimit normal, marrë në konsideratë jo vetëm organikën aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistencën e dy pozicioneve të lira të përkohshëm në të, ngarkesën aktuale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ku ajo është caktuar në mënyrë të përhershme, përfundimin e afatit të transferimit (zgjatjes) të përcaktuar me Vendim Nr. 204 datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga ana e Komisionit ju propozohet të vijohet transferimi i përkohshëm për këtë gjyqtare, duke përgatitur edhe projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni: 1. Gjyqtares {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 22.06.2022.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Punë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**